



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 644/24 Dt. 16.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në ftesën e Organizatës Ndërkombëtare "Promo Global" me seli në Zagreb të Republikës së Kroacisë, për lejin e udhëtimit zyrtar të Rasim Demirit, Bashkim Rakaj dhe Defrim Zajmi, për në Podgoricë dhe Budvë të Republikës së Malit të Zi, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën Ndërkombëtare "The Word Congress of Enterpreneus" që do të mbahet nga data 16 tetor 2024 deri me 19 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.

